



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY  
"ISA BOLETINI"  
MITROVICË**

**Kryesues mbledhjes së Këshillit Drejtues**  
Prof. asoc. dr. Halil Bajrami

Nr. Prot. 1602 Dt. 24.07.2023

Në bazë të nenit 24, pika 1.10 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, dhe nenit 6 paragrafi 2, të Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues, Këshilli Drejtues nxjerr këtë:

**KONKLUZION**

1. Këshilli Drejtues vazhdon mbajtjen e mbledhjeve të thirrura në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2023.
2. Mbajtja e mbledhjeve bëhet sipas Statutit të Universitetit dhe Rregullores së punës së Këshillit Drejtues.

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 21.07.2023, me shumicë të votave ka vendosur që më 24.07.2023, të mbahen dy mbledhje me qëllim që të vazhdojnë procedurat për zgjedhjen e rektorit të UIBM-së. Në të njëjtën datë (21.07.2023) janë njoftuar të gjithë kandidatët se intervistimi i kandidatëve do të bëhet më 24.07.2023, pas orës 11.00. Ky njoftim është publikuar edhe në web-faqen zyrtare të UIBM-së dhe ju është dërguar edhe mediave me qëllim të rritjes së transparencës së këtij procesi.

Më datë 24.07.2023 ishte planifikuar të mbahet mbledhja për shqyrtimin e listës së kandidatëve për rektor të UIBM-së. Në mbledhje nuk janë paraqitur 3 (tre) anëtarët e KD-së që janë përfaqësues të MASHTI-t. Në mbledhje kanë qenë prezent 4 (katër) anëtarët tjerë të KD-së të deleguar nga Senati i UIBM-së. Përkundër shumë përpjekjeve (thirrjeve telefonike, dërgimit të mesazheve dhe e-maileve zyrtar) të njëjtit nuk ishin lajmëruar për të arsyetuar mungesën e tyre në mbledhje. Mbledhja e datës 24.07.2023 ishte thirrur në pajtim me nenin 6 (4) të Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues që përcakton si në vijim: "Gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhjeje të ardhshme të Këshillit. Në këto raste, anëtarët e Këshillit Drejtues që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht".

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike dhe fakti se mbledhja është thirrur dhe kandidatët janë njoftuar për zhvillimin e procedurave, anëtarët e pranishëm të KD-së me qëllim që të respektohet ligjshmëria dhe rregullat e konkursit publik u pajtuan që të vazhdohet mbajtja e mbledhjeve të datës 24.07.2023, sipas vendimit të datës 21.07.2023 duke pasur parasysh se ka kuorum të mjaftueshëm.

Baza për mbajtjen e mbledhjes janë dispozitat e Statutit dhe Rregullores mbi Punën e Këshillit Drejtues, si më poshtë:

-Statuti i UIBM-së, neni 7, paragrafi 1: "Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues".

- Statuti i UIBM-së, neni 21, paragrafi 2 dhe 3: “Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet kuorumi prej katër (4) anëtarëve. Vendimet në Këshillin Drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë me një votim të hapur, vota e kryesuesit është përcaktuese”

-Rregullorja mbi Punën e Këshillit Drejtues, neni 13, paragrafi 1: “Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet kuorumi prej 4 (katër) anëtarëve. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të plotfuqishme vetëm nëse kuorumi vërtetohet në kohën e votimit”.

Rregullorja mbi Punën e Këshillit Drejtues, neni 6, paragrafi 1, 2: “1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i thërret dhe i kryeson kryesuesi i Këshillit Drejtues. 2. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson zëvendëskryesuesi. Nëse edhe kryesuesi edhe zëvendëskryesuesi nuk kanë mundësi të thërrasin apo marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Këshillit Drejtues e thërret dhe e kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues. Veprimi në kundërshtim me këtë paragraf paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës dhe sanksionohet konform akteve normative në fuqi”.

Në këtë drejtim dhe me qëllim të respektimit të akteve normative të lartcekura sipas administratës së UIBM-së, anëtari më i vjetër prezent në mbledhje i Këshillit Drejtues është prof. asoc. dr. Halil Bajrami dhe se ka kuorum për të vazhduar punën e Këshillit Drejtues. Prandaj, i njëjti në mungesë të kryesuesit dhe zv. kryesuesit do të kryesojë mbledhjet e Këshillit Drejtues të datës 24.07.2023.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të UIBM;
- Anëtarëve të KD-së
- Zyrës për Informim me Publikun
- Zyrës Ligjore

Kryesues i mbledhjes së Këshillit Drejtues

Prof. asoc. dr. Halil Bajrami

